VENDIM
Nr.346, datë 12.5.2010

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË TË ADMINISTRIMIT TË DISA MJEDISEVE, NGA KËSHILLI I MINISTRAVE TE AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1058, DATË 16.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të ndërtesës "Ish-Parku i Delegacioneve", që janë në përdorim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe të Autoritetit të Aviacionit Civil, konkretisht, një pjesë e katit të parë dhe kati i dytë i ndërtesës, nga Këshilli i Ministrave te Autoriteti i Aviacionit Civil, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Mjediset e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme, që i bashkëlidhet vendimit nr.1058, datë 16.7.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare".
3. Ngarkohen Kryeministria, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Autoriteti i Aviacionit Civil dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha


TRIA-E KATIT PARE


PLANIMETRIA E KATIT 0YTE

PLANTA ARQUIVOS 1:100



FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUJTSHME SHTETERORE

(Per invenatrizimin e pronave te veçanta)

Bashkia / Tirane

Fusha e perdorimit te prones: Automjetet e Delegacioneve

Identifikoi: M. Ngjeliu inxh ndertimi S. Janaqi inxh ndertimi
(emri,mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi : Aranit Xhekaj. Dr. Auditit
(emri,mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Drejtore Elsa Meksi
(emri, Mbiemri, pozicioni zyrtar, tel.firma vula)

Nr. Rend	A			B			C			
	Zona Kadastr.& Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e prones m/2	Nga sip. Totale: Sa ndertese m/2	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
12			Objekt Sherbimi	Parku i Delegacioneve Tirane Stadiumi Dinamo	5421	2916	Sherbim	K.Ministrave	D SH Q	